

... 3

2

1



Lehrplan 21

Një plan i ri mësimor për shkollën fillore të kantonit Bernë

Informacion për prindër

**Elterninformation
Albanisch**

Erziehungsdirektion des Kantons Bern
www.erz.be.ch



Në një vështrim

- > Plani i ri mësimor **Lehrplan 21** e përshkruan, siç çdo plan i deritanishëm mësimor, **detyrën e shoqërisë për shkollën**. Ai fikson se çfarë duhet t'i ndërmjetësojë brezit të ardhshëm shkolla fillore në fushën e **formimit të përgjithshëm**.
- > Plani mësimor **Lehrplan 21** u shërben mësueseve dhe mësuesve si **busull**, i cili i mbështet në planifikimin e mësimit.
- > Për herë të parë në historinë e Zvicrës **21 kantonet** gjermanofolëse dhe shumëgjuhësore do të kenë **të njëjtin plan mësimor**.
- > **Lehrplan 21** i harmonizon përmbajtjet e shkollës fillore me njëra-tjetrën. Por ai nuk e ndryshon shkollën rrënjësisht.
- > Në kantonin e Bernës **përmbajtjet dhe lëndët** mbeten **në thelb njëjloj**. Në mënyrë të re plani mësimor orientohet më shumë në atë që nxënëset dhe nxënësit të mos përvetësojnë vetëm dijeni, por të jenë gjithashtu në gjendje t'i zbatojnë ato (**orientimi ndaj kompetencës**).
- > **Lehrplan 21** e ndjek zhvillimin shoqëror: **Media dhe informatikë, matematikë dhe gjermanisht** marrin **më shumë leksione** sesa deri tani.

Hyrja

2



Shkollat kanë kohë të mjaftueshme për ta futur **Lehrplan 21**.

Në kantonin Bernë **Lehrplan 21** hyn në fuqi që nga dt. 1 gusht 2018 për kopshtin e fëmijëve dhe për vitin e 1-rë deri në vitin e 7-të shkollor. Një vit më vonë ai vlen edhe për vitin e 8-të shkollor dhe që nga gushti i vitit 2020 për vitin e 9-të shkollor.

Shkollat dhe mësimdhënësit marrin kohë të mjaftueshme për një futje të kujdesshme. Në fund të korrikut të vitit 2022 futja e planit mësimor do të jetë e përfunduar. Që atëherë gjithë mësimi duhet të orientohet në **Lehrplan 21**.

Për shkollat është në qendër zhvillimi i mësimin. Mësueset dhe mësuesit planifikojnë mundësi të zbatimit dhe zhvillojnë bashkërisht mësimin e tyre më tej. Në mënyrë të veçantë ata kujdesin që nxënëset dhe nxënësit të kenë mundësi të shumëllojshme për ta aplikuar dijeninë e përvetësuar. Lidhur me këtë ata mbështeten nga Shkolla e Lartë Pedagogjike, **Pädagogische Hochschule Bern (PHBern)**.

Orientimi ndaj kompetencës



Dijenja është baza e të gjitha kompetencave.

Plani aktual mësimor në kantonin Bernë është në fuqi që nga viti 1995. Ai i përshkruan **qëllimet mësimore**. **Lehrplan 21** bazohet në këto dhe përcakton **qëllime të kompetencës**. Këto përshkruajnë se çfarë duhet të dinë dhe duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënëset dhe nxënësit në fund të shkollimit fillor. Qëllimi është: Nxënëset dhe nxënësit duhet të jenë në gjendje që ta aplikojnë dijeninë e tyre sipas moshës dhe duhet të përgatiten mundësisht në mënyrë optimale për kualifikimet e tyre që çojnë më tej.

Në qendër të mëimit të orientuar ndaj kompetencës janë **detyra të larmishme**. Me përpunimin e tyre **nxiten kompetenca të ndryshme** të nxënësve dhe nxënësve.

Shkallët dhe lëndët

4

Për sa u përket lëndëve gati gjithçka mbetet siç ka qenë.

Lehrplan 21 është i ndarë në tre shkalle, të ashtuquajtura cikle: Kopshti i fëmijëve deri në klasën e 2-të, klasa e 3-të deri në klasën e 6-të, klasa e 7-të deri në klasën e 9-të.

Nxënëset dhe nxënësit mësohen në këto lëndë:

- **Deutsch** (gjermanisht); **Französisch** (frëngjisht); **Englisch** (anglisht)
- **Mathematik** (matematikë)
- **Natur, Mensch, Gesellschaft (NMG)** (natyra, njeriu, shoqëria)
- **Gestalten** (krijimi vizual, krijimi tekstil dhe teknik)
- **Musik** (muzikë)
- **Bewegung und Sport** (lëvizja dhe sporti)
- **Medien und Informatik** (media dhe informatikë)

Në **mësimin** e deritanishëm të **gjuhëve të huaja** nuk ka asnjë ndryshim: **Frëngjisht** mësohet **që nga klasa e 3-të, anglisht që nga klasa e 5-të**. Kjo praktikë vlen në kantonin e Bernës që nga viti 2011.

Lehrplan 21 përcakton, përveç kësaj, **tema ndërdisiplinore si Berufliche Orientierung** (orientimi profesional) dhe **Bildung für nachhaltige Entwicklung** (formim për zhvillimin e qëndrueshëm). Këto tema trajtohen në lëndë të ndryshme.

Tabela e leksioneve

5

Më shumë leksione – më pak detyra të shtëpisë

Lehrplan 21 i përforcon në kantonin Bernë lëndët **gjermanisht** dhe **matematikë**. Në krahasim me kantone të tjera këto lëndë kanë pasur deri tani tepër pak leksione.

Temat **media** dhe **informatikë** përforcohen gjithashtu: Për këtë parashikohet në vitin e 5-të dhe 6-të shkollor si dhe atë të 7-të dhe 9-të nga një leksion në javë.

Në vitin e 8-të dhe 9-të shkollor tabela e leksioneve parashikon tani të paktën tre leksione për **individuelle Vertiefung und Erweiterung (IVE)** (thëllimin dhe zgjerimin individual) në gjermanisht, matematikë dhe në gjuhët e huaja. Këto leksione mund të vihen në praktikë për përgatitjen e pikësnyuar të nxënësve dhe nxënësve për kualifikimet e tyre të mëtejshme (mësimi profesional, matura profesionale, gjimnazi, formime të tjera shkollore).

Si pasojë e numrit më të lartë të leksioneve **reduktohen detyrat e shtëpisë**. Maksimum për javë:

- **30 minuta** për kopshtin e fëmijëve deri në klasën e 2-të
- **45 minuta** për klasën e 3-të deri në klasën e 6-të
- **90 minuta** për klasën e 7-të deri në klasën e 9-të

Vlerësimi

6



Më pak raporte të vlerësimit –
biseda me prindërit bëhet akoma më e
rëndësishme.

Arritjet e fëmijëve dhe të të rinjve vlerësohen edhe më tej me **nota**.

Një rëndësi parësore ka në të ardhmen edhe **biseda me prindërit**. Edhe me **Lehrplan 21** mësueset dhe mësuesit zhvillojnë një bisedë në vit me prindërit. Në mënyrë të re marrëveshjet kryesore mund të mbahen në një **procesverbal të shkurtër**.

Raporti i sotëm i **vlerësimit** thjeshtësohet. Në mënyrë të re raporti i parë i vlerësimit jepet në fund të vitit të 2-të shkollor, pastaj përkatësisht në fund të vitit të 4-rt, 5-të dhe 6-të shkollor. Nxënëset dhe nxënësit e shkallës sekondare I (klasa e 7-të deri në klasën e 9-të) marrin tani **raporte vjetore të vlerësimit** në vend të raporteve gjashtëmujore. Kalimi në një nivel tjetër të kërkesave mund të bëhet edhe më tej gjatë vitit shkollor.

Procedura e kalimit



Lidhur me procedurën e kalimit gjithçka bëhet siç ka qenë.

Procedura e kalimit nga shkalla primare në shkallën sekondare I mbetet njëloj. Vendimtare mbeten lëndët **gjermanisht, frëngjisht dhe matematikë** dhe kompetencat ndërdisiplinore.

Në rast të **hyrjes në gjimnaz** që nga klasa e 8-të ose klasa e 9-të gjithçka mbetet gjithashtu njëloj. Vendimtare janë edhe më tej lëndët **gjermanisht, frëngjisht, matematikë dhenatyra, njeriu, shoqëria (NMG)**. Si deri tani, ka një procedurë rekomandimi, në të cilën merren parasysh kompetencat ndërdisiplinore.

Tani nxënëset dhe nxënësit marrin në fund të vitit të 7-të, 8-të und 9-të përveç raporteve të vlerësimit një **portofol për kompetencat e tyre ndërdisiplinore**. Atje dëshmohet ndër të tjera sa të pavarur dhe të besueshëm janë ata dhe sa mirë mund të punojnë ata në grup.

Kështu ndërmarrjet e shkollimit profesional ose shkollat që çojnë më tej marrin një ide për këto kompetenca të rëndësishme të të rinjve.

Mjetet mësimore



Ka nevojë vetëm për pak mjete të reja mësimore.

Shumica e mjeteve mësimore mund të vihen në veprim edhe me [Lehrplan 21](#). Në mënyrë të veçantë në lëndët gjermanisht, matematikë, anglisht dhe frëngjisht mjetet e sotme mësimore janë orientuar tashmë në mësimin e orientuar ndaj kompetencës.

Një **detyrim** për mjete të caktuara mësimore ka edhe më tej vetëm për **matematikë** dhe për **gjuhët e huaja**.

Në mësimin e matematikës të gjitha shkollat në kantonin Bernë punojnë me

- **Schweizer Zahlenbuch** për shkollën primare
- **mathbuch** për shkollën sekondare I

Në lëndën frëngjisht këto janë:

- **Mille feuilles** (viti i 3-të deri në vitin e 6-të shkollor)
- **Clin d'œil** (viti i 7-të - viti 9-të shkollor)

Në lëndën anglisht shkollat punojnë me

- **New World** (viti i 5-të - viti i 9-të shkollor)

Në lëndët e tjera shkollat marrin rekomandime dhe vendosin vetë, cilat mjete mësimore do të përdorin ato.



Të dashur prindër

Lehrplan 21 bazohet në arritje të provuara dhe merr parasysh zhvillime të reja. Qëllimi është nxitja më e mirë e nxënësve dhe nxënësve.

Për herë të parë 21 kantonet gjermanofolëse dhe shumëgjuhësore të Zvicrës do të kenë një plan të përbashkët mësimor. Kjo është me kuptim në vendin tonë me hapësira të vogla dhe i përgjigjet dëshirës së një shumice të madhe të popullsisë.

Plani i ri mësimor nuk e përmbys shkollën: Ai nuk sjell përmbajtje të re, por harmonizimin e qëllimeve.



Bernhard Pulver

Drejtor i arsimit i kantonit Bernë



Informacione të përgjithshme për shkollën fillore në kantonin Bernë gjeni nën: www.erez.be.ch/elterninfo